



Planuar / Doretuar Priljenj/Prilato Received/Delivety		14.02.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot (tr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKANDIŠTACK	753/2022		113	



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.31/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.31/2022 të datës 18.01.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë kundër Vendimit me Nr. Ref.BD-153/9 të datës 29.10.2021 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.02.2022, mori këtë:

### V E N D I M

PEZULLOHET procedura lidhur me ankesën me numër A.nr.31/2022 të datës 18.01.2022 të parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Ref.BD-153/9 të datës 29.10.2021 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për miratimin e Rregullos Nr.02/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullos së Pagave të nëpunësve të Agjencisë, me kërkesë për anulimin e të njëjtit.

Departamenti i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes emailit zyrtar të datës 03.02.2022, ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me Aktgjykimin C-IV-21-0231 të datës 01.02.2022 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përmes të cilit aktgjykim gjykata ka hedhur poshtë si të pa themeltë padinë/kërkesë padinë e përbashkët të ankuesve me të cilën kanë kërkuar anulimin

e Vendimit të Bordit të Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit Nr.Ref.BD-153/9 të datës 29.10.2021 lidhur me zbatimin e Rregullores Nr.02/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Pagave të nëpunësve të Agjencisë, si dhe Propozimin për masën e sigurisë me të cilin do t'i ndalohej të paditurës që të mos bëjë ulje të pagave deri në vendosjen e çështjes me vendim përfundimtar nga gjykata.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke marr parasysh se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktgjykimin C-IV-21-0231 të datës 01.02.2022 ka konstatuar se kërkesa/padia lidhur me objektin e padisë është e pranueshme për procedim në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, por e pathemeltë, dhe meqenëse Aktgjykimi C-IV-21-0231 i datës 01.02.2022 nuk është përfundimtar sepse kundër të njëjtit lejohet e drejta e ankesës brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit, Kolegji në mbështetje të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: "Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit", si dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për **pezullim të procedurës në lidhje me ankesën A.nr. 31/2022.**


Procedura lidhur me ankesën A.nr. 31/2022 e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, do të mbetet e pezulluar deri në vendosjen përfundimtare të kësaj çështjes në gjykatën kompetente.

Duke u bazuar si me lartë, dhe në mbështetje të nenit nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.31/2022**

*Ilire Mehmeti Shaqiri*  
  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Drejtorit Menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP);
- Udhëheqësit të Njesisë për Burime Njerëzore në AKP; dhe
- Arkivat të KPMSHCK-së.